

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“MUNDËSI” SHPK

Ortaku i vetëm themelues:

- **Z. Carmine Barbato**, shtetas italian, i datëlindjes 25.07.1974, lindur në Napoli dhe banues ne Rrugen Abamonti Giuseppe nr.7 , Casoria, Itali, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartes se identitetit italiane Nr. CA14783MG.

bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, sot më datë 27.04.2023, hartojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

NENI 1
Emri

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin **“MUNDËSI” SHPK**
Ndryshimi i emërtimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 2
Forma

Shoqëria tregtare **“MUNDËSI” SHPK** ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3
Zyra Qendrore

3.1. Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar **“MUNDËSI” SHPK**, do të ketë zyrën e saj qendrore në Shqipëri, Njesia Bashkiake nr 5, Rruga Donika Kastrioti 3, Kisha Apostolike e Re, Hyrja 2, Kati i 1, Apt.1, Nr.1, Tirane, Shqiperi.

3.2. Ndryshimi i zyrës qëndrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 4
Objekti i Veprimtarisë

Objekt i veprimtarisë së shoqërisë është: Shitje me shumice dhe pakice te pajisjeve te vogla dhe te meh dhe pjese kembimi te pajisjeve elektronike, fshesa me korent brenda dhe jashte territorit shqiptar, import-eksport. Shitje me shumice dhe pakice per lekure,veshje, kepuce brenda dhe jashte territorit shqiptar, import-eksport, shitje me shumice dhe pakice te lodrave te ndryshme per femije brenda dhe jashte territorit shqiptar, import-eksport. Shitje dhe dhenie me qera te makinave, kamionave, motocikletave (qera me qera), import-eksport. Shitje me shumice dhe pakice te pajisjeve elektronike, tablet, telefona, kompjuter, televizora, drita LED, artikujt te ndryshem shtepiake brenda dhe jashte territorit shqiptar, import-eksport, blerje dhe shitje kafe import-eksport. Sherbime transporti dhe shperndarje, logistike brenda dhe jashte territorit shqiptar. Blerje dhe Shitje me shumicë e pijeve alkoolike dhe joalkoolike. Blerje dhe shitje te paneleve fotovoltaike, proukte te gjelberta ekogendrueshme, import-eksport. Kompani Call Center. Blerje dhe shitje te pasurive te paluajtshme. Restorant. Blerje dhe shitje me shumice dh pakice te peleteve brenda dhe jashte territorit shqiptar. Blerje dhe shitje me shumice dhe pakice per produktet e mjekesore dhe kirurgje.

NENI 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar.

NENI 6
Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit



Shoqëria tregtare “MUNDËSI” SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7
Përgjegjësia e Ortakëve

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë “MUNDËSI” SHPK dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

NENI 8
Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “MUNDËSI” SHPK është 100.000 (njeqindmije) lekë, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga ortaku i vetem **Z. Carmine Barbato**.

NENI 9
Organet e Shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 10
Administratori

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Administrator i Shoqërisë është **Z. Carmine Barbato**.

NENI 11
Sekreti tregtar

Ortaku, administratori dhe punëmarrësit e shoqërisë “MUNDËSI” SHPK përgjigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkaktuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri.

NENI 12

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

Carmine Barbato.

BARBATO CARMINE
